VENDIM
Nr. 239, datë 28.4.2014

PËR SHLYERJEN E DETYRIMIT DOGANOR TË PRAPAMBETUR TË MINISTRISË SË MBROJTJES NDAJ DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr. 185/2013 "Për buxhetin e vitit 2014" dhe të vendimit nr. 50, datë 5.2.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shlyerjen e detyrimit doganor të prapambetur të Ministrisë së Mbrojtjes ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për vitin 2013, në shumën 478 714 581 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind e katërmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) lekë, deklaruar në listën e detyrimeve për artikullin 231, shpenzime kapitale për TVSH-në e papaguar.
2. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga zëri "Detyrime të prapambetura", të planifikuara në buxhetin e vitit 2014.
3. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama